

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 32 Prot

Gjirokastrë më, 09.01.2020

URDHËR

Nr. 04, datë 09.01.2020

"PËR NJËSIMIN E DOKUMENTIT ADMINISTRATIV"

Në mbështetje dhe në zbatim të Nenit 11, pika b, të Ligjit Nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe (ligjit specific) dhe Vendimin Nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë"

URDHËROJ:

1. Dokumentet administrative, të përpiluara sipas Normave Tekniko – Profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumentave kryhen si më poshtë :
 - Konceptoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë, nënshkrimi i konceptuesit.*
 - Pranoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë , nënshkrimi i përgjegjësit të Strukturës së nivelit të parë (nëse ka).*
 - Miratoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë , nënshkrimi i përgjegjësit të Strukturaës së nivelit të dytë (nëse ka).*
 - Konfirmoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë, nënshkrimi i zëvendësstitullarit, Juristit apo pozicionit tjetër të përcaktuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit.*
3. Dokumentet të përpilohen me shkrim Times Në Roman, me madhësi 12 dhe hapësira midis rreshtave të jetë 1.15, si dhe në anësore të lihen 3 cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2 cm.
4. Dokumentet të përpilohen në baze të rregullave drejtshkimore, ku të përdoren gërmat (ë) dhe (ç), si dhe kryeradhët.
5. Struktura të shënohet në dokumentet administrative vetëm në nivelin e strukturës më të lartë (Departamentit, Drejtorisë ose Sektorit sipas rastit) që ka konceptuar dokumentin. Titullari i institucionit është strukturë më vete, në rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai dhe në këto dokumente shënohet si strukturë më vete, emërtesa e titullarit, sipas organikës.
6. Përjashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produkt i pozicioneve të posaçme pune, të parashikuara në ligj dhe që nuk janë më vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës




përkatëse, ku ndodhet pozicioni i posaçëm sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të interes, Koordinatorin për të drejtën e Informimit, Njësia e Burimeve Njerëzore etj.

7. Njësia e Prokurimeve, Grupet ad – hoc të punës, Komisioni i Ekspertizës si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik në nivelin më të lartë drejtues shënohen si nënstruktura, poshtë strukture me emërtesën e titullarit, sipas organikës së institucionit.
8. Sekretari – Arkivi i institucionit njofton titullarin në të gjitha rastet kur shkresat nuk përpilohen sipas këtij urdhëri.
9. Ngarkohen strukturat e institucionit, pozicionet e posaçme të punës sipas ligjit dhe Sekretari – Arkivi për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR


Prof.dr Bektash Mema

